



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE

Tiranë me 29.04.2020

**Njoftim mbi përfundimin e procedurës “Lëvizje paralele”
dhe zhvillimin e procedurës: “Ngritje në Detyrë”, për pozicionin:
“Përgjegjës/e, në Sektorin e Financës”.**

Në zbatim të nenit 57, të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 26, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe të Kreut III-të, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, (i ndryshuar), në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentave personale (28.04.2020), të kandidatëve për konkurrim, me procedurën e lëvizjes paralele, asnjë kandidat nuk ka paraqitur dokumentat për konkurrim, për vendin e lirë të punës “Përgjegjës/e, në Sektorin e Financës”.

Njësia përgjegjëse pranë Gjykatës së Lartë (Sektori i Personelit dhe Shërbimeve) njofton se për vendin vakant “Përgjegjës/e, në Sektorin e Financës”, do të vazhdohet me procedurën: “Ngritje në Detyrë”.

Kandidatët do të paraqesin dokumentat me procedurën e “Ngritjes në detyrë”, deri me datën **04.05.2020** dhe do të marrin informacion në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure, duke filluar nga data **06.05.2020**.

NJËSIA PËRGJEGJËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE